

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 TEK NDËRMARRJET NË SHQIPËRI



NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 TEK NDËRMARRJET NË SHQIPËRI

Mbështetur nga



International
Labour
Organization



European Bank
for Reconstruction and Development

“Përgjegjësia për analizën dhe rekomandimet e anketës është përgjegjësi vetëm e autorëve të tyre, dhe botimi nuk përbën një miratim nga Zyra Ndërkombëtare e Punës për mendimet e shprehura në to”

Tiranë, 2020

NË LIDHJE ME ANKETËN

BiznesAlbania (BA) me mbështetjen teknike të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe në partneritet me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka zhvilluar anketimin e disa ndërmarrjeve për të vlerësuar ndikimin e pandemisë COVID-19 në veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Anketës iu përgjigjën 278 ndërmarrje gjatë periudhës kohore 14-30 Prill 2020.

Metodologjia:

Anketa në internet për BA u zhvillua bazuar në Instrumentin ILO-s për Anketimin e e Ndërmarrjeve në lidhje me situatën e shkaktuar nga COVID-19 për Organizatat e Anëtarësimit të Punëdhënësve dhe Biznesit (OAPB). Anketa iu shpërnda kompanive anëtare të BA.

Anketa në internet për BA u zhvillua bazuar në Instrumentin ILO-s për Anketimin e e Ndërmarrjeve në lidhje me situatën e shkaktuar nga COVID-19 për Organizatat e Anëtarësimit të Punëdhënësve dhe Biznesit (OAPB). Anketa iu shpërnda kompanive anëtare të BA.


Të gjitha të dhënat paraqiten në dy dimensione: sipas ndikimit të përgjithshëm dhe sektorit¹. Analiza sektoriale përfshin tetë sektorë, përkatësisht sektorin e ushqimit dhe pijeve, mikpritjen, shitjen me pakicë / shitjet, ndërtimin, produktet e tekstilit, lëkurës dhe veshjeve, bujqësinë / blegtorinë / peshkimin, informacionin dhe komunikimin, transportin dhe pajisjet e transportit². Sektorët janë përzgjedhur bazuar në rëndësinë strategjike të sektorit, ndjeshmërinë ndaj krizës dhe përfaqësueshmërinë në kampionin e anketuar.

¹ Anketa u përpoq të sillte një perspektivë sipas madhësisë së ndërmarrjes. Pikërisht për këtë anketë, u përshtat klasifikimi standard i përdorur nga ILO për të mundësuar vlerësimin global të ndikimit të COVID-19 tek ndërmarrjet që po kryhet nga kjo organizatë. Mikro-ndërmarrjet përcaktohen si ndërmarrje me deri në dhjetë të punësuar, ndërmarrjet e vogla si ndërmarrjet që kanë nga dhjetë deri në 100 të punësuar, ndërmarrjet e mesme si ndërmarrjet me 100 deri 250 punonjës, dhe ndërmarrjet e mëdha janë ato me më shumë se 250 të punësuar. Megjithatë, anketa nuk arriti të merrte një numër të mjaftueshëm përgjigjesh nga ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Ndërmarrjet mikro dhe të vogla përbënin deri në 94 përqind të madhësisë totale të kampionit. Prandaj, ky raport nuk ofron një analizë të detajuar sipas madhësisë së ndërmarrjes.


² Sektori i transportit do të shërbejë si ilustrim vetëm duke marrë parasysh madhësinë e pamjaftueshme të kampionit.

PROFILI I NDËRMARRJEVE TË ANKETUARA


Shpërndarja e ndërmarrjeve të anketuara sipas madhësisë



Shpërndarja e ndërmarrjeve të anketuara sipas llojit të pronësisë




Shpërndarja e ndërmarrjeve të anketuara sipas sektorit ku ushtrojnë aktivitetin e tyre









A është ndërmarrja juaj aktualisht funksionale?

Gati një e treta e ndërmarrjeve të anketuara nuk janë funksionale ndërsa gati 40% funksionojnë vetëm pjesërisht. Pak më pak se një e treta e ndërmarrjeve e ushtrojnë aktivitetin e tyre me kapacitet të plotë, qoftë në ambientet e tyre (24%) ose në distancë (7%).




Të analizuara brenda secilit prej sektorëve, të dhënat flasin se sektori i mikpritjes (78%) dhe ai i transportit (63%), të cilët kanë qenë të detyruara të mbyllën për shkak të kufizimeve të vendosura në kuadrin e gjendjes së jashtëzakonshme, kanë numrin më të lartë të ndërmarrjeve jofunksionale. Rënia e zinxhirëve të furnizimit dhe kërkesa e ulët e konsumatorit kanë ndikuar seriozisht edhe në sektorin e tekstilit, i cili është sektori i tretë më i goditur, ku 43% e ndërmarrjeve kanë raportuar mbylljen e plotë. Kur bëhet fjalë për shitjen me pakicë / shitjet, ushqimin dhe pijet, sektorët e ndërtimit dhe informacionit dhe komunikimit, mesatarisht më pak se një e pesta e ndërmarrjeve nuk janë funksionale në secilin prej këtyre sektorëve. Sektori i bujqësisë duket se është më pak i prekur. Aktivitetet bujqësore janë pothuajse në zhvillim të plotë me vetëm 5% të ndërmarrjeve të mbyllura.




A i keni ndryshuar operacionet e biznesit tuaj apo mënyrën e ofrimit të shërbimit për të mbrojtur ndërmarrjen tuaj nga COVID-19?

Për të lehtësuar pasojat e pandemisë, një pjese të madhe të ndërmarrjeve (83%) iu është dashur të ndryshonin operacionet e tyre të biznesit. Ndërmarrjet duhej të përshtateshin me kushtet e reja të vendosura nga qeveria (si distancimi fizik, vendosja e maskave mbrojtëse, higjienizimi i ambienteve etj.) për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve të tyre brenda mundësive.




Dallimet midis sektorëve nuk janë shumë domethënëse. Mesatarisht, gati 90% e ndërmarrjeve në sektorin e bujqësisë, ushqimit dhe pijeve, tekstilit, shitjes me pakicë / shitjeve dhe në sektorin e ndërtimit i kanë përshtatur operacionet e tyre. Sidoqoftë, në sektorët e mikpritjes dhe informacionit dhe komunikimit, ndërmarrjet kanë treguar një nivel fleksibiliteti më të ulët, me përkatësisht 24% dhe 29%, duke raportuar se nuk kanë bërë asnjë ndryshim në punën e tyre. Sektori i transportit, duke pasur parasysh specifikën e tij, e kishte më të vështirë të ndryshonte operacionet e punës, ku gjysma e ndërmarrjeve raportuan se nuk kishin bërë asnjë ndryshim në operacionet e tyre të biznesit dhe në mënyrën e ofrimit të shërbimeve.











Nëse kufizimet aktuale vazhdojnë, edhe për sa kohë do të jetë biznesi juaj funksional?

Është alarmues fakti që mbi një e pesta e ndërmarrjeve të anketuara parashikojnë se do të jenë në gjendje të ushtrorjnë aktivitetin e tyre për vetëm 1 deri në 8 javë në kuadrin e kufizimeve aktuale, ndërsa po i njëjti numër ndërmarrjesh parashikon që biznesi i tyre do të vazhdojë të jetë funksional për 2 deri në 3 muaj. 16% e ndërmarrjeve mund të mbijetojnë nga 3 deri në 6 muaj ndërsa disa ndërmarrje të tjera që përbëjnë një 16% tjetër të ndërmarrjeve të anketuara deklaruan që biznesi i tyre mund të vazhdojë të jetë i hapur ose për një periudhë nga 6 deri në një vit (9%) ose për më shumë se një vit (7%). 17% e ndërmarrjeve të anketuara nuk janë ndikuar nga pandemia COVID-19.




Nivele të moderuara qëndrueshmërie për 2 deri në 3 muajt e ardhshëm janë vënë re në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe pijeve, shitjes me pakicë / shitjeve, ndërtimit, informacionit dhe komunikimit. Nga ana tjetër, ndërmarrjet në sektorët e transportit, tekstilit dhe mikpritjes shfaqin qëndrueshmërinë më të dobët. Numri i ndërmarrjeve në sektorin e transportit (63%) që deklarojnë se do të jenë në gjendje të rezistojnë vetëm për një javë është veçanërisht shqetësues. Edhe numri i ndërmarrjeve të cenueshme në sektorët e tekstilit dhe mikpritjes që parashikojnë që aktiviteti i biznesit të tyre nuk do të zgjasë më shumë se një javë është i konsiderueshëm, me 24% dhe 21% respektivisht. Këta sektorë përmbajnë edhe numrin më të ulët të ndërmarrjeve që konfirmojnë se nuk janë ndikuar nga kriza, me 13% në transport dhe 10% në sektorin e tekstileve. Brenda sektorit të mikpritjes janë prekur nga kriza të gjitha kompanitë, pa asnjë përjashtim.








A ka ndërmarrja juaj një plan të shkruar për vazhdimësinë e biznesit?

Vetëm 50% e ndërmarrjeve të anketuara u përgjigjën se kishin një plan të shkruar për vazhdimësinë e biznesit.




Ekziston një mospërputhje midis sektorëve për sa i përket gatishmërisë për t'u përballur me kërcënimet e mundshme për vazhdimësinë e biznesit të tyre. Ndërmarrjet që deklarojnë mungesën e planit të vazhdimësisë në sektorin e mikpritjes (66%), transportit (63%), sektorin e ndërtimit (63%) dhe në sektorët e shitjes me pakicë / shitjeve (59%) gjenden shumë pozicione nën ndërmarrjet në sektorin e ushqimit dhe pijeve, informacionit dhe komunikimit, sektorët e tekstitil dhe bujqësisë, ku shumica e ndërmarrjeve u përgjigjën se kishin përgatitur një plan për adresimin e kërcënimeve të mundshme për biznesin e tyre.










Sa kohë do t'i duhej ndërmarrjes suaj për të rikuperuar operacionet plotësisht?

Për pothuajse 30% të ndërmarrjeve të anketuara do të nevojitej një periudhë nga 1 deri në 3 muaj për të rikuperuar plotësisht operacionet e tyre, ndërsa për gati 20% më shumë se 6 muaj. 18% parashikojnë që përpjekjet e tyre për rimëkëmbjen do të zgjasnin nga 1 deri 4 javë dhe 17% presin që aktiviteti i tyre i biznesit të rifillojë në më pak se një javë. 8% e të anketuarve janë duke parë mundësinë e mbylljes së biznesit të tyre përkohësisht ose përgjithmonë.



Brenda sektorëve të përzgjedhur, sektori i mikpritjes (41%) dhe ai i tekstilit (29%) kanë numrin më të madh të ndërmarrjeve që parashikojnë një periudhë të gjatë rimëkëmbjeje prej më shumë se 6 muaj. Nga ana tjetër, sektorët me numrin më të madh të ndërmarrjeve që parashikojnë rikuperimin më të shpejtë brenda një jave ishin transporti (29%), sektori i informacionit dhe komunikimit (25%), sektori i ushqimit dhe pijeve (20%) dhe sektori i bujqësisë (17%). Në të njëjtën kohë, 16% e ndërmarrjeve brenda sektorit të shitjes me pakicë / shitjeve, 14% brenda transportit, 10% nga ushqimi dhe pijet dhe tekstili dhe 7% nga mikpritja janë duke studiuar mundësinë e mbylljes së aktivitetit për një periudhë të përkohshme ose përgjithmonë.

Kështu, aftësia e ndërmarrjeve për t'u rikuperuar ndryshon nga sektori në sektor dhe madje edhe midis segmenteve të ndryshme brenda sektorëve në varësi të ndikimit të krizës në aktivitetin e tyre të biznesit dhe kufizimet e vendosura gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Sektorët më të goditur si mikpritja, transporti dhe tekstili do të kenë nevojë për një periudhë më të gjatë rikuperimi, ndërsa sektori i informacionit dhe komunikimit parashikon një rimëkëmbje relativisht të shpejtë. Perceptimi i ndërmarrjeve në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe pijeve dhe shitjes me pakicë / shitjeve ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në varësi të llojit të veprimtarisë së tyre të biznesit dhe pozicionit brenda zinxhirëve të vlerës.




A ka qenë i siguruar biznesi juaj para se të ndodhte kriza COVID-19?


Vetëm 35% e bizneseve kanë qenë të siguruara para se të ndodhte kriza; 25% kanë qenë të siguruara pjesërisht; dhe 40% nuk kanë qenë të mbuluara me asnjë lloj sigurimi.



Ndarja sektoriale paraqet një kopje të përafërt të situatës së përgjithshme në sektorët e ushqimit dhe pijeve, mikpritjes, shitjes me pakicë / shitjeve, ndërtimit dhe informacionit, ku rreth 32% e bizneseve të tyre ishin plotësisht të mbuluara me sigurim, pak më shumë sesa një e katërta ishin të siguruara vetëm pjesërisht dhe mbi 40% nuk ishin të siguruara fare. Sektorët e tekstilit dhe bujqësisë portretizojnë një tablo paksa të ndryshme ku një numër më i madh biznesesh, përkatësisht mbi 70%, ishin të mbuluar plotësisht ose pjesërisht me sigurim. Nga ana tjetër, pjesa e biznesit të siguar në sektorin e transportit është nën mesataren sektoriale me 50% ndërmarrje që pranojnë se nuk kanë qenë të mbuluara me asnjë lloj sigurimi.



Bujqësi / Blegtori / Peshkim




Ushqim dhe pije




Tekstil, lëkurë dhe veshje




Transport dhe pajisje transporti




Mikpritje



Shitje me pakicë / Shitje




Ndërtim










Informacion dhe komunikim

Cili ka qenë niveli i ndikimit financiar (në të ardhura ose shitje) në biznesin tuaj dhe në ndërprerjen e operacioneve të biznesit?

Për më shumë se gjysmën e ndërmarrjeve të anketuara ndikimi financiar i krizës mbi bizneset është konsideruar i lartë (mbi 50% rënie e të ardhurave / shitjeve), ndërsa më shumë se një e pesta e perceptuan atë si të mesëm (20% - 50% rënie). Një pjesë relativisht e vogël (9%) mendonin se ndikimi financiar ishte i ulët (deri në 20% rënie) dhe 3% vërejtën një ndikim pozitiv të krizës në bizneset e tyre.




Analiza e kryer në brendësi të sektorëve tregon se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve që kanë pësuar një rënie të lartë brenda të ardhura/ shitjeve është në sektorin e mikpritjes (72%), ndërtimit (67%), transportit (57%), ushqimit dhe pijeve (56%) dhe në sektorët e shitjes me pakicë / shitjeve (56%). Numri i ndërmarrjeve që raportojnë rënie të lartë është disi më i ulët brenda sektorit të bujqësisë (50%), sektorit të tekstilit (43%) dhe sektorit të informacionit dhe komunikimit (44%). Një numër relativisht i ulët përjashtimesh është vënë re në përgjigjet e anketës ku disa sektorë shënojnë një rritje pozitive në shitje / të ardhura. Këto përfshijnë sektorin e bujqësisë (6%), ushqimit dhe pijeve (5%), tekstilit (10%) dhe sektorin e informacionit dhe komunikimit (6%).










A keni fonde vetjake (p.sh. para të gatshme, kursime) ose qasje tek burimet alternative / të jashtme (p.sh. huatë ose grantet) të financimit për të ndihmuar rimëkëmbjen e biznesit?

Mesatarisht, 35% e ndërmarrjeve të anketuara nuk kanë qasje tek asnjë fond, ndërsa 27% varen nga kreditë dhe grantet për të ndihmuar rimëkëmbjen e bizneseve të tyre. Nga ana tjetër, 30% e ndërmarrjeve kanë paratë / kursimet e tyre.



Numri më i madh i ndërmarrjeve që kanë vënë në dukje mungesën e financimit gjendet brenda sektorëve të mëposhtëm: sektori i ushqimit dhe pijeve (49%), sektori i tekstit (48%), i bujqësisë (44%) dhe sektori i mikpritjes (41%). Sektorët e tjerë pasqyrojnë perceptimin e përgjithshëm, ku rreth 30% e ndërmarrjeve kanë deklaruar mungesën e likuiditetit.


Nga ana tjetër, numri më i madh i ndërmarrjeve që kanë patur qasje tek huatë dhe grantet janë brenda sektorit të transportit (57%), bujqësisë (44%) dhe ndërtimit (38%). Brenda sektorëve të komunikimit dhe shitjes me pakicë/ shitjeve, dhe sektorit të ushqimit dhe pijeve, përkatësisht 50%, 48% dhe 37% kanë raportuar që kanë patur para të gatshme në dorë.









A keni larguar ndonjë punonjës për shkak të COVID-19?

Nëse po, cila është përqindja e fuqisë punëtore të larguar nga puna?

Disa shifra alarmuese të evidentuara kanë të bëjnë me faktin që më shumë se 40% e ndërmarrjeve të anketuara i kanë larguar punonjësit e tyre për shkak të COVID-19, ndërsa gati 60% arritën t'i mbanin ata në marrëdhënie pune. Për ndërmarrjet që kanë larguar punonjësit e tyre, pothuajse gjysma ka pushuar një të tretën e punonjësve të tyre, ndërsa mbi 30% kanë pushuar një pjesë të vogël nga 1% deri në 5%. Përveç kësaj, 7% e ndërmarrjeve kanë pushuar nga puna nga 11% deri në 20%, ndërsa 7% të tjerë pushuan nga puna nga 21% deri në 30% të punonjësve të tyre. Një grup tjetër ndërmarrjesh prej 8% kanë larguar një pjesë relativisht më të vogël të punonjësve nga 6% deri në 10%.




Sipas analizës sektoriale ndërmarrjet që kanë reduktuar numrin e fuqisë së tyre punëtore në mënyrë të konsiderueshme janë nga sektori i mikpritjes (75%), transportit (63%), tekstilit (62%) dhe nga sektori i bujqësisë (60%). Numri i ndërmarrjeve që u detyruan të largojnë punonjësit e tyre nga puna është tronditës. Në mënyrë të veçantë, ndërmarrjet që deklarojnë se iu është dashur të pushojnë më shumë se një të tretën e fuqisë së tyre punëtore përbëjnë 80% të ndërmarrjeve brenda sektorit të shitjes me pakicë / shitjeve, 74% brenda sektorit të mikpritjes, 60% brenda sektorit të transportit, dhe 50% brenda sektorit të ushqimit dhe pijeve. Brenda sektorit të ndërtimit 33% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se shkalla e largimit të punonjësve të tyre shkon nga 21% deri në 30%. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve brenda sektorit të bujqësisë (75%) kanë qenë të detyruara të pushonin nga 1% deri në 5% të punonjësve të tyre. Një përqindje e ngjashme punonjësish (1% - 5%) janë larguar nga puna kryesisht brenda sektorit të tekstilit (50%), transportit (40%), ushqimit dhe pijeve (28%), ndërtimit (22%) dhe sektorit të shitjes me pakicë / shitjeve (20%).










A planifikoni të largoni ndonjërin prej punonjësve për shkak të COVID-19? Nëse po, cila është përqindja e fuqisë punëtore që planifikoni të largoni gjatë tremujorit tjetër?

Nëse kufizimet vazhdojnë, perspektiva e shkurtimit të vendeve të punës është shqetësuese, ku 52% e ndërmarrjeve sinjalizojnë se do të detyrohen të përdorin masën e largimit nga puna. Midis këtyre ndërmarrjeve, një e pesta planifikon të largojë nga puna rreth një të tretën e punonjësve të tyre, ndërsa 14% planifikojnë të largojnë nga puna 21% deri në 30% dhe 11% dhe 20% të punonjësve të tyre secila. 30% e ndërmarrjeve planifikojnë të largojnë një pjesë më të vogël të fuqisë së tyre punëtore nga 1% deri në 5%.




Me sytë nga e ardhmja, perspektivat e shkurtimeve të vendeve të punës janë shqetësuese. Pjesa më e lartë e ndërmarrjeve që konfirmojnë planin e tyre për të larguar punonjësit janë nga sektori i mikpritjes (78%), transportit (71%), tekstilit (67%), ushqimit dhe pijeve (57%) dhe nga sektori i bujqësisë (55%). Në përgjithësi, përqindja e punonjësve që mund të largohen nga puna ndryshon nga sektori në sektor dhe brenda sektorëve vetë. Nga ndërmarrjet që planifikojnë të largojnë punonjësit, pjesa më e madhe e atyre që mund të detyrohen të largojnë nga puna mbi një të tretën e fuqisë së tyre punëtore janë në sektorin e transportit (60%), mikpritjes (30%), tekstilit (21%), shitjes me pakicë / shitjeve (20%) dhe në sektorët e informacionit dhe komunikimit (20%). Një pjesë e konsiderueshme e kompanive planifikojnë të pushojnë nga 1% deri në 5% të fuqisë së tyre punëtore, përkatësisht në sektorin e tekstilit (57%), bujqësisë (50%), transportit (40%) dhe në sektorin e ndërtimeve (33%).




SFIDAT KRYESORE ME TE CILAT PO PËRBALLEN NDËRMARRJET PËR SHKAK TË COVID-19

Cilat janë sfidat kryesore me të cilat po përballet ndërmarrja juaj aktualisht si rezultat i COVID-19?

Në përgjithësi, sfidat më të rënda me të cilat janë përballur ndërmarrjet janë: kërkesa e ulët për produkte dhe shërbime (68%), deficieti i kapitalit punues (65%) dhe mungesat e punëtorëve për shkak të sëmundjes dhe kufizimeve qeveritare (36%), e ndjekur nga afër nga paaftësia e partnerëve të biznesit për të punuar normalisht (35%).




Më poshtë gjeni sfidat më të mëdha me të cilat janë duke u përballur ndërmarrjet aktualisht sipas sektorëve:




Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)

- 26% Paaftësia e partnerëve të biznesit për të punuar normalisht
- 21% Paaftësia e furnitorëve për të siguruar input-et
- 5% Tjetër


Ushqim dhe pije Sfidat e rënda




Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)




Tekstil, lëkurë dhe veshje Sfidat e rënda




Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)




Transport dhe pajisje transporti Sfidat e rënda




Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)



Mikpritje Sfidat e rënda




Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)



Shitje me pakicë / Shitje Sfidat e rënda




Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)




Ndërtim Sfidat e rënda




Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)



Informacion dhe komunikim Sfidat e rënda



Sfidat më pak të rënda (në më pak se një e treta e rasteve)



REKOMANDIME

Si pasojë e krizes së krijuar nga COVID-19 Qeveria shqiptare miratoi një sërë masash për të përballuar situatën dhe për ti dhënë një shtysë ekonomisë e cila u pasua nga mbyllje biznesesh dhe papunësi. Këto masa konsistuan në dhënien e dy Garancive Sovrane për të ndihmuar biznesin. Garancia e parë Sovrane, prej 100 milionë dollarësh, iu dha në muajin Prill bizneseve të mëdha që të paguanin pagat e punonjësve të tyre, mos shkurtonin vendet e punës përmes marrjes së kredive në banka me normë interesi 2, 85% me shtetin garant për kolateralin. Garancia e dytë Sovrane prej 150 milionë dollarësh do ti jepej biznesit të vogël dhe atij të mesëm. Shteti kontribuon me 60% të interesit bankar të kredive, kurse 40% vetë bizneset.

Për bizneset me qarkullim deri në 14 milionë lekë këstet e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 nuk do të paguhen. Për bizneset me qarkullim mbi 14 milionë lekë, këstet e tatimit mbi fitimin për bizneset me qarkullim mbi 14 milionë lekë për tremujorin e dytë dhe të tretë do të shtyhen për të njëjtën periudhë të vitit të ardhshëm. Këstet e tatimit mbi fitimin për periudhën prill-dhjetor 2020 që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit, fasonerisë dhe call center nuk do të paguajnë për 2020 por për të njëjtën periudhë në vitin 2021.

Keto masa u mirëpritën nga bizneset në përgjithësi., por ka akoma çështje që duhet të merren parasysh.

BiznesAlbania propozon që të merren parasysh dhe rekomandimet që kanë ardhur nga bizneset, të cilat duhen konsideruar për t'iu mundësuar ndërmarrjeve, punëtorëve dhe familjeve të tyre të përballen me sfidat që vijnë nga COVID-19:

Masat e lehtësimit të taksave sipas sektorëve të goditur më rëndë: Ndërmarrjet në sektorët e hoteleri turizmit, ndërtimit, tekstiles, lëkurës dhe sektorët e tjerë më të goditur tu shtyhet afati për pagimin e detyrimeve tatimore. Ndërmarrjet kërkojnë mbështetjen tonë më të madhe për rimëkëmbjen duke marrë parasysh nivelin e dëmtimit që ata kanë pësuar. Afati për të paguar detyrimet tatimore duhet të pezullohet për një periudhë 3 mujore.

Kredi me interes të ulët: Norma e interesit për këto kredi të jetë 0 për qind në vitin e parë dhe gjithashtu të shtyhet pagesa e principalit të kredive për 1 vit. Të rishikohet marrëveshja me bankat sepse ka një paqartësi dhe hezitim nga sistemi bankar për dhënien e kredive për pagat e punonjësve. Ndhima financiare të mos konsiderohet e mbyllur me dy garancitë sovrane por duhen ndihmuar ndërmarrjet me likuiditete dhe kredi të shpejta me terma të buta dhe me afate të gjata në shlyerje.

Fondet për punonjësit: Qeveria të aplikojë garancinë e dytë sovrane me qëllim që hapja graduale e ekonomisë të shoqërohet me dhënie kredish për bizneset që rinisin punën. Ndërmarrjet me goditje më të mëdha kërkojnë grante qeveritare në formë të parave për të paguar punonjësit e tyre.

Në sektorin e bujqësisë qeveria shqiptare duhet të rrisë ndjeshëm financimin me grante për të gjithë fermerët shqiptarë të cilët kanë pësuar humbje nga situata e pandemisë COVID-19.

Në sektorin e transportit të përshpejtohen procedurat e import-eksportit fakti që procedurat raportohen se ishin shumë të ngadalta nuk ndihmoi fare në përballimin e situatës.

Në sektorin e tekstileve Prodhimi i veshjeve, këpucëve të policisë, ushtrisë, institucioneve të cilët kanë një uniform të prodhohen në fasoneritë që operojnë në tregun shqiptar për ti ndihmuar që të mbijetojnë, gjithashtu shteti të negocjojë me vendet e huaja për vazhdimësinë e marrëveshjeve të lidhuar për prodhimin e veshjeve këpucëve.

Në fushën e turizmit: Cdo njësi akomoduese duhet të ketë një koordinator anti-Covid-19, i cili do të trajnohet nga autoritetet kompetente për të gjithë procedurën dhe masat parandaluese që duhet të ndërmerren me qëllim trajnimit nga ana e tij të stafeve respektive. Koordinatorin duhet të hartojë një rregullore të brendshme, në përputhje me këtë protokoll masash, do t'i caktojë detyra konkrete stafit si dhe do të marrë masa për furnizimin me mjetet dhe logjistikën e nevojshme. Në çdo rast, i gjithë stafi duhet të pajiset përgjatë gjithë periudhës së shërbimit, me doreza dhe maska mbrojtëse të higjienizuara.

Të ketë një mbështetje për kontratat me vizitorë të huaj që të mbrohen sa më mirë, sepse kompanitë e huaja që kanë kontrata me agjenci dhe hotele në Shqipëri po bëjnë gjithçka që të marrin garanci 100 për qind. Për të gjitha kontratat që do të shtyhen për vitin tjetër, të përdoret garanci financiare nga qeveria dhe të jetë pa interes. Një mekanizëm nga qeveria që të motivojë vendasit që të bëjnë pushime në Shqipëri.

Të rimburohet TVSH-ja dhe ulja e tarifës për energjinë elektrike.

Kompanitë e informacionit dhe komunikacionit të vazhdojnë fushatat e informacionit për të edukuar klientët rreth COVID-19. Ata të subvencionohen nga shteti për dhënien e internetit falas për të miturit dhe studentët që vazhdojnë mësimin online dhe nuk kanë mundësi ekonomike.

Protokollet e hapjes së bizneseve të bëhen në konsultim me shoqatat e biznesit dhe me tendencë lehtësimi dhe sa më pak kosto për sipërmarrjen.

Transporti publik: Në periudhën e pandemisë është shumë e vështirë transporti i punonjësve për shkak të bllokimit që ka pësuar transporti publik. Për këtë arsye duhen marrë masa të menjëhershme për organizimin e transportit në rast të ndonjë vale të re që mund të ndodhë vitin tjetër.

Besimi publik-privat për rimëkëmbjen e COVID-19: Të rishikohet dhe një herë paketa e ndihmës financiare për bizneset të cilët janë nga sektorët më të prekur nga COVID-19 si fasoneria, hoteleri turizëm, agrobiznes etj.

Bashkimi i Biznesit te Shqiperise

Tirane, Rr. Marko Bocari, Nd.6, H.1, Nr.1

info@biznesalbania.org.al

www.biznesalbania.org.al

+ 355 42204270